



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:094667
Datë: 06.08.2024
Numri i dokumentit: 06020938

CA.nr.8305/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nehat Idrizi, kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të propozueses së sigurimit L. H, nga Gj..., rr. ..., të cilën me autorizim e përfaqëson Avdi Rizvanolli, avokat në Gjakovë, ndaj kundërshtares së sigurimit D. Q., nga Gj..., rr. ..., Gjakovë, kati ..., për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të propozueses të masës së sigurimit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.836/24, të datës 22.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të propozueses të masës së sigurimit L. H., nga Gj..., rr. ..., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.836/24, i datës 22.05.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar C.nr.836/24, të datës 22.05.2024, në pikën një të dispozitivit të saj, e ka hedhur poshtë si të palejueshëm propozimin për caktimin e masës së sigurimit të udhëhequr nën shenjën 2024:094667, të datës 25.03.2024, të paraqitur nga propozuesja e masës së sigurimit me objekt ndalimi i kundërshtares së sigurimit D. Q., nga Gj..., që të ngarkoj, tjetërsoj, bartë në pronësi apo dorëzoj në posedim personave të tretë paluajtshmerinë pronë e tyre, e cila evidentohet si ngastra kadastrale numër ..., me shfrytëzim aktual banesë, kati ..., hyrja ..., ZK- Gj..., si dhe në pikën dy, secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktvendimi ka paraqitur ankesë propozuesja përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, të merr vendim që ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e atakuar ta ndryshojë, duke e aprovuar kërkesën

e palës propozuese, apo ta prish vendimin dhe çështjen të ia kthej Gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesja me datë 25.03.2024, ka paraqitur propozim kundër kundërshtares së sigurimit, për caktimin e masës së sigurimit. Me aktvendimin C.nr.836/24, të datës 26.03.2024, i ka kthyer propozueses në plotësim propozimin për caktimin e masës së sigurisë. Propozuesja përmes të autorizuarit të saj, me datë 28.03.2024, ka paraqitur parashtresë me të cilën ka njoftuar Gjykatën se nuk ka mundur të i sjell dokumentet e kërkuara.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit paraprak të propozimit, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, duke e hedhur poshtë si të palejuar propozimin e propozueses për caktimin e masës së sigurimit.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata ka theksuar propozimi me të cilin propozuesja e ka kërkuar masën e sigurimit, nuk është pajisur me provat me të cilat vërtetohen pretendimet e propozueses, përkatësisht nuk ka prova me të cilën vërtetohet vdekja si dhe raporti familjar ndërmjet të ndjerit B. Q., që pretendohet të jetë vëllai i propozueses së sigurimit, e rrjedhimisht edhe bashkëshorti i kundërshtares së sigurimit, andaj Gjykata duke u bazuar në nenin 99, par.2, dhe 102, të LPK-së, ka obliguar propozuesen e masës së sigurimit përkatësisht të autorizuarin e saj, të paraqitur në propozim, që të njëjtin ta plotësoj me prova, dhe atë, certifikatën e vdekjes dhe aktvdekjen, për të ndjerin B. Q., ku me parashtresën e datës ..., i autorizuari i propozueses së sigurimit, i ka bashkangjitur certifikatën e vdekjes, raportin e emergjencës nr..., të datës ..., mirëpo nuk i ka bashkangjitur aktvdekjen, me arsyetimin se të njëjtin mund ta nxjerrin vetëm familjaret e të ndjerit, dhe se për këtë i duhet kohë shtesë.

Për mënyrën e vendosjes, Gjykata në shkallë të parë, ka vendosur në pajtim me nenin 99 par.2, 102 par.2 dhe 3, 392 par.1, pika g), si dhe nenin 7, të LPK-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës, gjithashtu e mori në pajtim me nenin 450, të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë, nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore në ankesë të autorizuarit të propozueses për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore me pretendimin se dispozitivi i aktvendimit është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e tij, ngase kjo gjykatë vlerëson se dispozitivi i aktvendimit është i qartë, e në

përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata në shkallë të parë, ka vendosur drejtë në momentin kur e ka hudhur poshtë propozimin e propozueses si të palejueshem për caktimin e masës së sigurimit, pasi që fillimish, i autorizuari i palës propozuese, është dashur të dijë pasojat që mund të rrjedhin pergjatë procedurës, që në fillim me paraqitjen e propozimit, që në rast mungese të provave, të hudhet poshtë propozimi për masë, e që edhe perkunder vërejtjeve të Gjykatës, i njëjti nuk ka mundur të njëjttat të i sigurojë.

Me nenin 304, paragraf 3 të LPK-së, përcaktohet se: “Në propozimin për caktimin e masave të sigurimit propozuesi i sigurimit duhet ta tregojë në të kërkesën, për sigurimin e të cilës bënë propozim, masën e sigurimit që e propozon, mjetet dhe objektin e masës së sigurimit. Në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtuara në propozim. Propozuesi i sigurimit ka për detyrë po që se ka mundësi, që mjetet provuese t’ia bashkëngjitë propozimit”.

Sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, 391 par.1, pika g), të LPK-së, e parasheh që: “Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme, po që se konstaton se: paditësi brenda afatit të caktuar nga Gjykata nuk i ka hequr mungesat, nga neni 79 dhe 102, të LPK-së”, kështu që me të drejtë edhe Gjykata e shkallës së parë, ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Në rastin konkret, Gjykata e Apelit, vlerëson se përfundimi i gjykatës së shkallës së parë për mënyrën e vendosjes është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi propozuesja kërkesës së saj, nuk ia ka bashkëngjitur provat apo dëshmitë të cilat i ka kërkuar Gjykata që të vërtetohet vdekja si dhe raporti familjar ndërmjet të ndjerit B. Q., që pretendohet të jetë vëllai i propozueses së sigurimit, e rrjedhimisht edhe bashkëshorti i kundërshtares së sigurimit, këtu D. Q., kështu pa ofruar prova bindëse në lidhje me kërkesën apo të drejtën subjektive të saj, të cilin qëndrim si të bazuar në ligj, e aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e tjera ankimore të autorizuarit të propozueses, por nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana apo shkelje të tilla që do të ndikonin për nxjerrjen e një vendimi ndryshe, për çka edhe vendosi si dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- NË PRISHTINË

CA.nr.8305/24, me datë 02.08.2024

Kryetari i kolegjit
Nehat Idrizi d.v
